REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Kavajë, më _____._____.2026

PROJEKT-V E N D I M
Date ___/.___/ 2026

Për
"Përcaktimin e kritereve për dhënien e ndihmes ekonomike për familjet aplikuese të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen, nëpërmjet përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike dhe dhenien e Ndihmes Ekonomike per familjet ne nevoje nga fondet e Bashkise "

Në mbështetje të nenit 8 , pika 2,nenit 9, pika1, nenpika1.1, shkronjat a dhe b , nenit 24 , nenit 55, pikat 2 dhe 6, te ligjit nr.139\2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, ligjit Nr. 57/2019 "*Për asistencen sociale ne Republiken e Shqiperise*",Kreut IV , pikat 2,3 dhe 6, te VKM nr. 597, date 04.09.2019, te Keshillit te Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", te ndryshuar, Vendimit nr.868, dt.29.12.2021 te K.M. "Per disa ndryshime dhe shtesa ne VKM nr.597 dt.04.09.2019, te Keshillit te Ministrave", " Per percaktimin e procedurave, te dokumentacionit dhe te mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike", vendimit nr.59, dt.16.12.2025 te Keshillit Bashkiak "Per miratimin e programit Buxhetor afatmesem 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit te Bashkise Kavaje per vitin 2026" konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresen nr.1752/prot, dt.24.12.2025 si dhe referuar relacionit permbledhes, Drejtoria e Shërbimit Social, Sektori i Ndihmes Ekonomike me propozim të Kryetarit të Bashkise z.Fisnik Qosja i paraqet Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e rradhes:

TË MIRATOJË

1. **Kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% si më poshtë:**

a) Familjet që refuzohen nga sistemi I pikëzimit për mungesë pikësh por që jetojnë në kushtet e varfërise në banesa të pa përshtatshme.

b) Familjet që refuzohen nga sistemi I pikëzimit për mungesë pikësh por që janë të varfëra dhe kanë fëmijet në shkollë të moshës nën 18-vjeç, dhe nuk kanë anëtarë madhor të tjerë në punë.

c) Familjet që refuzohen nga sistemi I pikëzimit për mungesë pikësh por që janë të varfëra dhe njëri nga prindërit është person me aftësi të kufizuar, por femijët janë nën moshë pune.

d) Familjet që refuzohen nga sistemi I pikëzimit për mungesë pikësh por që janë të varfëra dhe k/familjare është nëna, dhe fëmijët janë në shkollë.

2. **Kriteret mbi përcaktimin e procedurave, për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtezuar (6%) të buxhetit vendor si më poshtë:**

- Prioritet do te kenë familjet me nevoja sociale ekonomike ku perfshihen:
- Familjet të papuna me më shumë se 3 fëmijë nën moshën 18 vjec,
- Familjet të papuna me 1 anëtar, (te mos jetë si rezultat I ndarjes nga trungu familjar)
- Familjet të papuna me një prind, ku kryefamiljare është nëna.
- Familjet burre e grua me moshe mbi 55 vjec të pa punë e pa të ardhura.
- Gratë e veja të pa puna me fëmije nen moshën 18 vjec.
- Cdo familje në nevojë pa të ardhura e cila nuk ploteson nevojat bazë jetike

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social (Sektori Ndihmës Ekonomike), Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Njësite Administrative të Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

Drejtoria Sherbimit Social
Xhulja Uzuni

Drejtoria Burimeve Ligjore
Helidon Plaku

Drejtoria e Burimeve Ekonomike
Albi Lushka

Sekretari Keshillit Bashkiak
Meri Biturku

KRYETARI

FISNIK QOSJA